



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1024/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Bibaj Sh.P.K me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1058/17, të datës 16.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.10.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1058/17, të datës 16.03.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr.1058/17, të datës 16.03.2021, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Bibaj Sh.P.K nga Ferizaj. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është anuluar aktvendimi me nr.07.3/852/2014 i datës 06.06.2017, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe Aktvendimi nr.05.1/329 datë 13.05.2014 i lëshuar nga Sektori i Kontrollit Pas Importues me të cilin paditësi Bibaj Sh.P.K nga Ferizaj është obliguar të paguaj obligimet shtesë në emër të taksave doganore në shumën prej 34,775.44€ si vendime të pabazuara në ligj.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar A.nr. 1058/17 të datës 16.03.2021 ta prishë si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me datë 17.06.2021 i autorizuari i paditësit ka dorëzuar përgjigje ne ankesë, duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit e ushtruar ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal A.nr.1058/17 datë 16.023.2021 dhe të vërtetohet si i bazuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal A.nr.1058/17 datë 16.023.2021.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/852/2014 i datës 06.06.2017 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë Bibaj Sh.P.K me seli në Ferizaj, për rishqyrtimin e aktvendimit 05.1/329 datë 13.05.2014 të lëshuar nga Sektori i Kontrollit Pas Importues si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 23.06.2017, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.07.3/852/2014 i datës 06.06.2017, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas

administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se nga administrimi i provave konstaton se në këtë çështje administrative doganore kjo gjykatë me Aktgjykimin A.nr.1703/14 datë 22.11.2016 ka aprovuar padinë e paditësit, ka anuluar aktvendimin nr.07.3/852 datë 05.08.2014 i të paditurës dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje. Gjykata me këtë Aktgjykim ka dhënë vërejtje se e paditura nuk ia ka dorëzuar palës paditëse gjatë procedimit administrativ provat e siguruara nga autoritetet doganore të Turqisë nuk i ka dhënë mundësin paditësit që të deklarohet apo të ballafaqohet me provat 7 deklaratat eksportuese dhe faturat e sjellura nga autoritetet doganore Turke, manifestet e ngarkesave të mallit. Gjykata ka dhënë konstatimin se nuk mund të ngarkohet paditësi me detyrime doganore shtesë me deklaratat eksportuese që nuk janë në emër të paditësit, dhe në këtë kuptim është kërkuar nga e paditura që në rivendosje të jep sqarime plotësuese dhe të siguroj prova shtesë ashtu që të vërtetohet nga Kontrolli Pas Importues/Dogana e Kosovës se e kanë lidhshmëri emrat e subjekteve që gjenden në deklarata eksportuese me paditësin, të vërtetohet se a ekzistojnë këta subjekt të regjistruar në Kosovës dhe të shikohet se a është zhvilluar ndonjë procedurë e kontrollit ndaj këtyre subjekteve. Në arsyetim të vendimit lidhur me vërejtjet e gjykatës përkitazi me statutin e subjekteve tjerë emrat e të cilëve gjenden në deklarata eksportuese dhe fatura, Sektori i Kontrollit me datë 05.05.2017 ka pranuar një përgjigje me shkrim e-mail nga ARBK-ja, se në data bazë të ARBK-së nuk është hasur informata në sistem për bizneset në fjalë. Edhe pse gjykata i ka bërë me dije të paditurës se është e papranueshme të ngarkohet paditësi me obligime doganore shtesë, në bazë të provave të reja si deklaratat eksportuese, faturave, nga shteti eksportues Turqi, që nuk janë në emër të paditësit, mirëpo në rastin konkret e paditura i është shmangur këtij rekomandimi të gjykatës edhe pse në rivendosje e paditura gjithashtu nuk ka mund të vërtetoj as në ARBK se paditësi ka lidhshmëri me subjektet emrat e të cilave gjenden në deklaratat eksportuese si MS Marketing-Montenegro, DOO MS Marketing ShPK dhe MS Marketing Kosovo ShPK.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave

të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpatria e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruara prova për të vërtetuar gjendjen faktike por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit, tutje nga pretendimet ankimore thuhet se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë të kujdesshme provat e administruara dhe se këndejmi del se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas nenit 8.2 të LKP-së që do të thotë se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban arsyetim përkitazi me faktet vendimtare të kësaj çështje juridike. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse nga provat materiale gjykata ka konstatuar se në këtë rast e paditura ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike si rezultat i së cilës në mënyrë të kundërligjshme ka obliguar paditësin që ti paguaj taksat doganore shtesë në mënyrë retroaktive për periudhën 3 vite pas zhdoganimit të mallit. Tutje gjykata konstatimin lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga provat materiale të administruara në konflikt administrativ e ka mbështetur edhe nga ekspertiza financiare e datës 08.02.2021 e cila nga ndryshimet që u janë bërë DUD-ave kontestues IM4 R-15587/12.08.2010, R-22626/03.11.2010, R-3726/25.02.2011, R-6118/26.03.2011, R-10361/03.05.2011, R-11343/24.04.2011, R-18013/06.06.2012, r-4054/24.02.2012, R-2315/27.01.2013 ka dhënë mendimin profesional juridik, se transaksionet bankare të paditësit janë në përputhshmëri të plotë me vlerën e mallit të cilën e ka faturuar furnitori-eksportuesi i mallit lëndor, kartela analitike vërteton se të gjitha blerjet referuar faturave

blerëse janë paguar përmes transferove bankare, dhe nga vlerat shitëse rezulton se ato korrespondojnë me vlerat e deklaruar me rastin e importimit të mallit lëndor. E paditura në asnjë rast nuk ka provuar të verifikoj se ka ndonjë ndryshim në transaksionet bankare të paditësit lidhur me pagesat e mallit lëndor që janë bërë për eksportuesin Seha Muhendislik Musavirlik Tie Ve-Turqi, fakte këto të cilat do të mbështetin konstatimin e të paditurës se paditësi ka paguar vlerë më të lartë se sa vlera e deklaruar me Deklaratat Unike doganore kontestuese të cekura si më lartë. Gjykata konstaton se e paditura nuk ka vepruar drejt kur ka obliguar paditësin të paguaj obligimet shtesë në emër të taksave doganore, pasi që nga provat e reja të siguruara nga autoritetet doganore të shtetit eksportues Turqi, është vërtetuar se deklaratat eksportuese, faturat eksportuese nuk janë në emër të paditësit dhe në këtë rast nuk mund të mbaj përgjegjësi paditësi për shkak të veprimeve nga personat e tretë, emrat e të cilëve gjenden në deklaratat eksportuese dhe që nuk është vërtetuar me asnjë provë se paditësi ka ndonjë lidhje tregtare me këta subjekt si MS Marketing-Montenegro, DOO MS Marketing ShPK dhe MS Marketing Kosovo ShPK. Gjithashtu gjykata në këtë konflikt administrativ posedon prova të mjaftueshme për të vendosur në mënyrë meritore këtë konflikt administrativ në pajtim me nenin 81.1 par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 nenit 43 par.3, 46 parag.4 të LKA-së.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1024/22, me datë 12.10.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**